



UNMIK/DIR/2005/3  
11 shkurt 2005

---

## URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2005/3

### PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/4 MBI NDALIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Prëgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 13 të Rregullores nr. 2001/4 të datës 12 janar 2001 mbi ndalimin e trafikimit në Kosovë,

Me qëllim të qartësimit të përgjegjësiave të koordinatorit të ndihmës së viktimës, të themelimit të fondeve për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit, krijimit të një komisioni për rishikim për hlumtimin e vendimeve të koordinatorit për ndihmë viktimave dhe dhënies së ndihmës shtesë për viktimat e trafikimit dhe dëshmitarëve jashtë Kosovës,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative:

#### Neni 1

#### Koordinatori për ndihmë të viktimave

- 1.1 Koordinatori për ndihmë viktimave ("Koordinatori"), të cilin e emëron Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Prëgjithshëm në pajtim me nenin 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 do të caktohet për Departamentin e Drejtësisë.
- 1.2 Koordinatori, në mes tjerash :
  - (a) në koordinim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa zhvillon një strategji për marrjen e fondeve, mes tjerash, nga gjobat e gjykatave, nga prona e konfiskuar (në pajtim me nenin 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4),

nga kontributet individuale apo të dhuruara, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe nga burime të tjera;

- (b) Krijon mekanizma për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit në formë të fondeve;
  - (c) Vendos kriteret dhe procedurat për vlerësimin e kërkesave të dorëzuara nga viktimat e trafikimit për ndihmë dhe kompensim, për marrjen e vendimeve rreth kërkesave të tilla dhe për lehtësimin e dhënies së ndihmës ë tillë;
  - (d) Ofron ndihmë për viktimat e trafikimit që marrin pjesë në seanca gjyqësore në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4;
  - (e) Koordinon me autoritetet e UNMIK-ut dhe palët tjera relevante politikatat dhe veprimet që ndërlidhen me trafikimin me njerëz;
  - (f) Nxjerr raport gjysmëvjetor mbi trafikimin me njerëz në Kosovë, duke përfshirë të dhëna rreth madhësisë së problemit dhe numrit, statusit dhe gjendjes së lëndëve që janë ndjekur penalisht sipas Ligjit penal në fuqi;
  - (g) Ngrit vetëdijen rreth çështjes së trafikimit me njerëz në Kosovë dhe të drejtave të viktimave të trafikimit;
  - (h) Kërkon këshilla rreth lëndëve dhe çështjeve që ndërlidhen me trafikimin e njerëzve që janë të mitur, të sëmurë mentalisht apo të paafte në ndonjë mënyrë tjetër dhe
  - (i) Nën mbikëqyrjen dhe, varësisht nga leja e ZPSSP-së për Polici dhe Drejtësi, bashkëpunon në suaza të përpjekjeve rajonale dhe ndërkombëtare për luftimin e trafikimit dhe për dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit.
- 1.3 Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, koordinatori punon ngushtë me autoritetet e UNMIK-ut, autoritetet për zbatimin e ligjit, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare dhe palët tjera relevante, sipas nevojës.

## Neni 2

### Fondet për ndihma në raste të trafikimit dhe për kompensimin e trafikimit

- 2.1 Me anë të kësaj themelohet një fond për ndihma në raste të trafikimit me qëllim të dhënies së ndihmave financiare për viktimat e trafikimit.
- 2.2 Fondi për ndihma në raste të trafikimit është i autorizuar për pranimin e mjeteve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, sidhe nga kontributet e donatorëve. Të gjitha kontributet në fondin për ndihma në raste të trafikimit, depozitohen në një

vijë buxhetore, nën Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, që do të rezervohet veçanërisht për qëllim të dhënies së ndihmës financiare për viktimat e trafikimit.

- 2.3 Me anë të kësaj themelohet fondi për kompensimin e trafikimit me qëllim të ofrimit të kompensimit për viktimat e trafikimit.
- 2.4 Fondi për kompensimin e trafikimit është i autorizuar që të pranojë fonde nga prona e konfiskuar në përputhje me nenin 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si dhe nga kontributet tjera të donatorëve. Të gjitha kontributet në Fondin për kompensimin e trafikimit depozitohen në një vijë buxhetore, nën Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, që do të rezervohen veçanërisht për qëllim të dhënies së kompensimit për viktimat e trafikimit.

### Neni 3

#### Komisioni për rishikim

- 3.1 Themelohet Komision për rishikime për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të koordinatorit mbi kërkesat për ndihma apo kompensime.
- 3.2 Komisioni për rishikime përbëhet nga:
  - (a) Një gjykatës i Gjykatës Supreme dhe
  - (b) Dy anëtarë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Policia e UNMIK-ut apo ndonjë organizatë tjetër relevante ndërqeveritare apo joqeveritare, me përvojë profesionale në fushën e trafikimit me njerëz.
- 3.3 Anëtarët e Komisionit për rishikim dhe zëvendësuesit për secilin prej tre anëtarëve, emërohen nga Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtësi. Emërimet bëhen për një periudhë njëvjeçare, me mundësi të riemërimit vetëm edhe për një vit .
- 3.4 Punimet e Komisionit për rishikim realizohen në pajtim me këtë Udhëzim administrativ, nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1949 dhe Rregulloren e punës së miratuar nga Komisioni për rishikim.
- 3.5 Në pajtim me Rregulloren e punës të miratuar nga Komisioni për rishikim, anëtari i Komisionit për rishikim zëvendësohet nga një anëtar zëvendësues, në rastet kur njohuria paraprake profesionale dhe personale e anëtarit të tillë të Komisionit për kërkuesin është e atillë që ai nuk është , apo konsiderohet se nuk mund të jetë i paanshëm në shqyrtimin e e ankesës.

### Neni 4

#### Kërkesat për ndihmë apo kompensim

4.1 Viktima e trafikimit mund të kërkojë nga koordinatori pranimin e:

- (a) Shërbimit falas të përkthimit në gjuhën që e zgjedh ai;
- (b) Këshillave juridike falas për procedura civile apo penale lidhur me çështjet e trafikimit;
- (c) Strehimit të përkohshëm të sigurt dhe ndihmës psikike, mjekësore dhe sociale, sipas nevojës;
- (d) Ndihmës në riintegrimin e parashtruesit të kërkesës në shoqëri, duke përfshirë lehtësimin e riintegrimin të familjes së parashtruesit të kërkesës dhe kontaktimit të shoqatave adekuate të komunitetit apo organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare;
- (e) Në se parashtruesit të kërkesës nuk është nga Kosova,

(i) Ndihmë për planifikimin e kthimit në shtetin ku parashtruesi i kërkesës paraprakisht ka banuar apo nënshtetësinë e të cilit e ka, duke përfshirë pajisjen me dokumente të udhëtimit dhe gjësendeve të nevojshme siç janë valixhet, veshmbathja apo pako e gjësendeve elementare të nevojshme për udhëtim dhe organizimin e udhëtimit deri në destinacionin e fundit apo

(ii) Ndihmë për kontaktimin e organizatave ndërqeveritare, joqeveritare apo të tjera në shtetin ku parashtruesi i kërkesës paraprakisht ka banuar, apo nënshtetësinë e të cilit e ka, e që mes tjerash ofrojnë ndihmë mjekësore, ligjore, psikike, sociale dhe financiare, për viktimat e trafikimit me njerëz.

- (f) Ndihmë financiare nga Fondi për ndihma në raste të trafikimit, që ndërlidhet me ndihmën nga paragrafi (a) – (e) të nenit 4.1, apo për nevoja të mjeteve të jetesës ose
- (g) Kompensim nga Fondi për kompensimin e trafikimit, për kompensimin e dëmit që ka pësuar parashtruesi i kërkesës .

4.2 Kërkesa nga neni 4.1 (f) apo 4.1 (g) bëhet me shkrim dhe shoqërohet me çdo dokument apo dëshmi të disponueshme. Kërkesa mund të jetë në gjuhën e parashtruesit të kërkesës . Kërkesa përmban këto të dhëna:

- (a) Emrin, datën e lindjes dhe adresën e parashtruesit të kërkesës ;
- (b) Emrin dhe adresën e përfaqësuesit ligjor apo mbrojtësit të viktimës, në qoftë se ka;
- (c) Shtetin ku banon apo nënshtetësinë e të cilit e ka parashtruesi i kërkesës ;

- (d) Rrethanat nën të cilat është trafikuar parashtruesi i kërkesës , duke përfshirë, në se është e mundshme, datën apo periudhën kur është trafikuar parashtruesi i kërkesësi;
- (e) Gjendjen financiare të parashtruesit të kërkesës , duke përfshirë deklaratën për mjetet financiare apo të tjera në Kosovë dhe çdo person vartës që e mbështet ai ;
- (f) Çdo kërkesë për dëmshpërblim, për grante financiare apo për ndihma, dorëzuar gjykatës apo ndonjë subjekti tjetër, grante financiare apo ndihma që i ka dhuruar gjykata a ndonjë subjekt tjetër për apo në lidhje me incidentin e trafikimit në të cilin bazohet kërkesa ;
- (g) Çdo ndihmë e dhuruar prej koordinatorit në mënyrë të përsheptuar në përputhje me nenin 7 dhe
- (h) Lloji i ndihmës apo shuma e ndihmës financiare ose kompensimit të kërkuar.

4.3 Kërkesa sipas neneve 4.1 (f) apo 4.1 (g) dorëzohet brenda gjashtë muajve nga data kur ka pushuar shfrytëzimi i parashtruesit të kërkesës. Koordinatori mund të pranojë kërkesa që dorëzohen pas këtij afati nëse parashtruesi i kërkesës e asrjeton mosrespektimin e afatit.

4.4 Asgjë në këtë Udhëzimi administrativ nuk e ndalon viktimën e trafikimit nga paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim financiar në ndonjë gjykatë kompetente kundër ndonjë personi të kyçur në trafikimin e viktimës së tillë.

4.5 Kërkesa sipas neneve 4.1 (a) – 4.1 (e) mund të dorëzohet me shkrim apo gojarisht. Koordinatori mund të shpallë udhëzime për dorëzimin e kërkesave të tilla.

## Neni 5

### Vendimet mbi kërkesat për ndihmë apo kompensim

- 5.1 Nëse koordinatori konstaton se ka bazë për të besuar se parashtruesi i kërkesës është viktimë e trafikimit, ai miraton dhe lejon ndihmën e tillë dhe/ose kompensimin siç kërkon viktima, varësisht nga disponimi i mjeteve në Fondin për ndihma në raste të trafikimit dhe/apo Fondin për kompensime të trafikimit.
- 5.2 Në përcaktimin e shumës së duhur të ndihmave dhe kompensimin financiar për t'ju dhuruar viktimës së trafikimit, koordinatori, mes tjerash, merr parasysh rrethanat financiare të viktimës dhe vartësve të tjerë, si dhe çdo dëmshpërblim, grant financiar apo ndihmë që tashmë i është dhuruar viktimës dhe bilancin e mjeteve në disponim për ndihmën apo kompensimin financiar të viktimave të tjera të trafikimit.

- 5.3 Koordinatorin nxjerr vendim për parashtruesin e kërkesës për ndihmë apo kompensim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës së tillë. Vendimi bëhet me shkrim dhe përmban arsyet për atë vendim.
- 5.4 Brenda dhjetë (10) ditëve nga data e lëshimit të vendimit, koordinatori ia kumton parashtruesit të kërkesës t vendimin e marrë , si dhe udhëzimet për të drejtat e tij në ankesë dhe për mbrojtësin e viktimës që do ta ndihmojë parashtruesi e kërkesës.
- 5.5 Viktima e trafikimit që pranon ndihmë dhe/apo kompensim financiar është i obliguar që të tregojë për mjetet e tilla sa më herët që të jetë e mundur, kur kërkon dëmshpërblim, grante financiare apo ndihmë nga gjykata apo ndonjë subjekt tjetër.

#### Neni 6

##### Ankesat kundër vendimeve të koordinatorit

- 6.1 Parashtruesi i kërkesës mund të ankohet në vendimin e koordinatorit. Ankesa me shkrim i dorëzohet Komisionit për rishikim brenda dhjetë (10) ditëve nga data kur parashtruesi i kërkesës pranon vendimin.
- 6.2 Koordinatorin i siguron Komisionit për rishikim të gjitha informatat dhe materialet e nevojshme përkatëse për marrjen e një vendimi të bazuar.
- 6.3 Komisioni për rishikim lëshon vendim për ankesën sa më shpejtë që të jetë e mundur, , brenda shtatë (7) ditëve nga data e pranimit të ankesës. Vendimi lëshohet me shkrim dhe përmban arsyet për marrjen e tij.
- 6.4 Komisioni për rishikim ia kumton vendimin koordinatorit, parashtruesit të kërkesës dhe çdo përfaqësuesi ligjor apo mbrojtësit të viktimës që ndihmon parashtruesin e kërkesës brenda dhjetë (10) ditëve nga data e lëshimit të vendimit.
- 6.5 Vendimi i Komisionit për rishikim është i formës së prerë.
- 6.6 Koordinatorin siguron zbatimin e vendimit të Komisionit për rishikim sa më shpejtë që të jetë e mundur brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lëshimit të vendimit.

#### Neni 7

##### Kërkesat e përshpejtuara për ndihmë

- 7.1 Viktima e trafikimit mund të parashtrojë kërkesë tekkoordinatorin për pranimin e ndihmës nga paragrafet (a) – (f) të nenit 4.1 me procedurë të përshpejtuar.

- 7.2 Kërkesa e viktimës së trafikimit për pranimin e ndihmës me procedurë të përshpejtuar përmban çdo dokumentacion apo dëshmi në dispozicion dhe sqarimin pse ndihma e tillë nevojitet urgjentisht për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies së viktimës, apo për parandalimin e dëmtimit të papërmirësueshëm të interesave të tij. Nëse kërkesa është për ndihmë me procedurë të përshpejtuar të përshkruar në paragrafin (f) të nenit 4.1, atëherë kërkesa përfshinë dhënat e parapara në nenin 4.2.
- 7.3 Koordinatori lejon ndihmën me procedurë të përshpejtuar, varësisht nga disponimi i mjeteve në Fondin për ndihma në raste të trafikimit, nëse ai konstaton se:
- (a) Ka arsye për të besuar se parashtruesi i kërkesës është viktimë e trafikimit dhe
  - (b) Ndihma nevojitet urgjentisht për mbrojtjen e sigurisë, shëndetit apo mirëqenies së viktimës ose për parandalimin e dëmtimit të papërmirësueshëm të interesave të tij.
- 7.4 Koordinatori menjëherë lëshon një vendim për kërkesën e dorëzuar në përputhje me nenin 7.1 brenda tri (3) ditëve nga data e pranimit të kërkesës .
- 7.5 Koordinatori menjëherë ia komunikon parashtruesit të kërkesës dhe çdo përfaqësuesi ligjor apo mbrojtësit të viktimës vendimin e tij dhe udhëzimet mbi të drejtën e parashtruesit të kërkesës në ankesë.
- 7.6 Vendimi i koordinatorit për refuzimin e parashtruesit të kërkesës për marrjen e ndihmës me procedurë të përshpejtuar nuk e ndalon viktimën e trafikimit nga dorëzimi i kërkesës sipas nenit 4.
- 7.7 Parashtruesi i kërkesës mund të ankohet kundër vendimit të koordinatorit të lëshuar në përputhje me nenin 7.4 brenda tri (3) ditëve nga data kur parashtruesi i kërkesës pranon vendimin.
- 7.8 Komisioni për rishikim lëshon vendimin mbi ankesën sa më shpejtë që të jetë e mundur, brenda tri (3) ditëve nga data e pranimit të ankesës.
- 7.9 Komisioni për rishikim menjëherë ia komunikon vendimin e vet koordinatorit, parashtruesit të kërkesës dhe çdo përfaqësuesi ligjor apo mbrojtësi të viktimës që ndihmon parashtruesin e kërkesës. .
- 7.10 Koordinatori siguron zbatimin e vendimit të Komisionit për rishikim sa më shpejtë që të jetë e mundur, brenda tri (3) ditëve nga lëshimi i vendimit.
- 7.11 Nenet 4 deri në 6 të këtij Udhëzimi administrativ zbatohen përshtatshëm për kërkesat për pranimin e ndihmës me procedurë të përshpejtuar.

#### Neni 8

#### Ndihma shitesë për viktimat e trafikimit dhe të dëshmitarëve jashtë Kosovës

Viktima e trafikimit apo dëshmitari jashtë Kosovës që mund të ofrojë informata gjatë hetimit të lëndëve që kanë të bëjnë me trafikimin e njerëzve, mund, t'i lejohet autorizim i përkohshëm për të mbetur në Kosovë dhe për ofrimin e mbrojtjes adekuate për periudha dhe kushte të atilla që autoriteti përgjegjës konsideron të përshtatshme.

#### Neni 9

#### Ndihma nga përfaqësuesi ligjor dhe mbrojtësi i viktimës

Përfaqësuesi ligjor apo mbrojtësi i viktimës ose përfaqësuesi i ndonjë organizate joqeveritare, ndërqeveritare apo qeveritare mund të dorëzojë kërkesë për ndihmë apo kompensim, kërkesë për ndihmë me procedurë të përshpejtuar apo ankesë kundër një vendimi të koordinatorit, në emër të viktimës së trafikimit me pëlqimin e viktimës së tillë.

#### Neni 10

#### Hyrja në Fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 26 shkurt 2005

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm